



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Lënda: Masat administrative dhe juridike lidhur me detyrimet e prapambetura të aktiviteteve sezonale

**DREJTORISË SË FINANCËSM, PLANIFIKIM TË BUXHETIT DHE
MENAXHIMIT TË ASETETEVE**

Drejtoria e të ardhurave në Bashkinë Himarë bazuar në autoritetin dhe kompetencën që i jep ligji ka ndjekur një plan të detajuar masash për subjektet debitore në tërësi dhe për ato që kryejnë aktivitete sezonale në vecanti.

Së part këto kompetenca ushtrohen duke zbatuar metodat e vlerësimit të riskut për të përcaktuar në çdo rast masën më të përshtatshme të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura

Kriteri i vlerësimit të riskut bazohet në dokumentacionin financiar që disponon drejtoria duke marrë parasysh shumën e detyrimit të papaguar, historikun e këtij detyrimi dhe aftësinë paguese të subjektit.

Pasi konstatohet që subjekti nuk ka paguar të tërë apo pjesërisht detyrimin tatimor ose detyrime të tjera ndaj Bashkisë Himarë i dërgohet me postë një njoftim dhe kërkesë për të paguar me shumën e detyrimit dhe afatin perfundimtar.

Nëse subjekti nuk përdor të drejtën e ankimimit por as nuk paguan, drejtoria e të ardhurave, fillon procedurat për mbledhjen me forcë duke përdorur njëerën ose disa prej mënyrave të parashikuara në ligj.

Në rastet kur zotërohen prova konkrete dhe të besueshme se pagesa e detyrimeve është në rrezik, administrata mund të kërkojë pranë organeve kompetente:

- 1.ndalimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të adminislratorit, ortakut dhe aksionarit të personit juridik apo individit tregëtar
- 2.ndalimin e transferimit jashtë shtetit të shumave të depozituara në llogarite bankare në emër të individit.

Nëse subjekti nuk shlyen brenda afateve të percaktuara në njoftimin dhe kerkesën për pagesë detyrimet e prapambetura nëpërmjet një urdhëri me shkrim të lëshuar nga titullari i institucionit i kërkohet cdo banke të nivelit të dytë në Shqipëri të bllokojë shumën e detyrimit.


Pas komunikimit me bankat e nivelit të dytë dhe evidentimit të shumave në llogaritë aktive të subjektit debitor .dërgohet urdhër ekzekutimi për të kaluar shuma në favor të Bashkisë Himarë.

Nëse edhe në këtë fazë nuk arketohen detyrimet e prapambetura detyrimi sigurohet në favor të Bashkisë Himarë mbi të gjitha pasuritë e debitorit.

Masa mund të jet barrësiguruese apo barrë hipotekore. Para vendosjes së saj subjekti njoftohet me shkrim.

DREJTOR I QREJTORISË

Flobens Dilaveri



Konceptoi: A.Konomi